

Në bazë të nenit 20 të ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike si dhe ne baze te nenit 29 te po këtij ligji, në bazë të nenit 130 te Ligjit Nr. 06/L-016 Për Shoqëritë tregtare, dhe në mbështetje te dispozitës nga paragrafi 2, i Nenit 14, të Ligji Nr. 04/L-060 Për Mbeturina, ne baze te nenit 20.23 te Kodit te Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, si dhe ne bazë të nenit 7 te Statutin e Kompanisë për Menaxhimin e Deponive ne Kosove SH.A, Bordi i Drejtoreve te KMDK SH.A me seli ne Prishtine, miraton këtë:

## **RREGULLORE NR. 24/2020, PER METODOLOGJINE E LLOGARITJES SE TARIFËS SË SHËRBIMIT NE MENAXHIMIN E DEPONIVE SANITARE TË KMDK SH.A**

### **KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Qëllimi**


##### **Neni 1**

- 1) KMDK SHA përmes dispozitave të kësaj rregulloreje përshkruan metodologjinë e kalkulimit dhe te llogaritjes së tarifës së shërbimit konform praktikave të mira për të përcaktuar koston reale të shërbimit mbi menaxhimin adekuat të kompanisë dhe të operimit në deponitë sanitare si dhe stacionin e transferit me të cilat operon kompania.
- 2) Me këtë rregullore adresohet përmbajtja e strukturës së aktiviteteve që duhet të përfshihen në kalkulimin e zërave të kostove të shpenzimeve përfshirë edhe fitimin për të përcaktuar një tarifë reale mbi operimin dhe menaxhimin e deponive.

#### **Fusha e shtrirjes**

##### **Neni 2**

- 1) Dispozitave të kësaj rregulloreje i nënshtrohet komisioni i veçantë i emëruar nga Kryeshefi Ekzekutiv (KE) i KMDK SHA për të përgatitur projekt-propozimin e tarifës se shërbimit për operimin dhe menaxhimin e deponive sanitare.
- 2) Projekt-propozimi i tarifës i nxjerre nga komisioni duhet të jetë i bazuar në analizën e saktë financiare dhe me bazë të mjaftueshme arsyetimi, që me pastaj si i tille t'i drejtohet në forme kërkesë Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit për miratim.



*RA*

## KAPITULLI II KOMISIONI, DETYRAT, PROPOZIM-KRERKESA DHE AFATET

### Kërkesa për caktim të tarifës

#### Neni 3

- 1) Bazuar në paragrafin 2, i Neni 14, të Ligji Nr. 04/L-060, "Për Mbeturina" kompetent për caktimin e tarifës së deponimit është Ministria e Zhvillimit Ekonomik (*ne cilësinë rregullatorit*) tash ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA).
- 2) KMDK SHA duhet të paraqesë propozim-kërkesën me shkrim për koston e tarifës së shërbimit në MEA. Kërkesa duhet të bëhet në format letre (kopje fizike) e nënshkruar dhe e vulosur në përputhje me procedurat e përcaktuara ligjore mbi dokumentet zyrtare.
- 3) KMDK SHA gjithashtu, në raportin vjetor që i dërgon Njesisë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike në kuadër të MEA, do t'i paraqesë shkurtimisht brenda raportit edhe nevojat për ndryshim të tarifës me shpjegimin e shkurtër mbi mbulueshmërinë e kostove të shërbimeve.

### Afatet dhe përmbajtja e kërkesës

#### Neni 4

- 1) KMDK SHA në çdo fund vit apo fillim viti do t'i paraqes MEA/rregullatorit kërkesën për caktim të tarifës, në rast se kjo nuk është e përcaktuar ndryshe me dispozitë të veçantë nga MEA apo qeveria.
- 2) Përmbajtja e kërkesës për propozim-tarifë do të shoqërohet me një përshkrim që pasqyron procesin e pranimit të mbeturinave në deponi, mënyrën e trajtimit dhe asgjësimit të tyre, si dhe evidencën mbi sasinë e aktiviteteve përkatëse për vitin mëparshëm dhe vitin aktual.
- 3) KMDK SHA, së bashku me kërkesën për tarifën mund të paraqesë edhe dokumente të tjera që lidhen me justifikimin dhe arsyetimin e kostove, që formojnë propozim-tarifën, në rast se një gjë e tillë kërkohet nga MEA, apo nëse gjatë procesit mund të specifikohen me akte të veçanta të aprovuara nga ministria si kuadri rregullator për caktimin e tarifës për mbeturina.
- 4) KMDK SHA do të rishikojë afatet apo edhe të ndryshojë modelin e përcaktimit të koston në rast se një gjë e tillë kërkohet nga MEA (rregullatori) gjatë procesit të vlerësimit të propozim-tarifës.
- 5) KMDK SHA do ta respektojë afatin ligjor të periudhës së përcaktuar për kohëzgjatjen e tarifës, ndërsa për periudhën kohore derisa të përcaktohet një tarifë e re, si valide e merr e mbajtjen e saj në fuqi edhe pas skadimit të afatit të vendimit.
- 6) KMDK SHA do të bëjë mbajtjen e të dhënave individuale dhe së bashku me propozim-tarifën, në rast se kërkohet do t'i paraqesë rregullatorit një raport mbi kostot dhe të ardhurat që kanë të bëjnë me vjeljen eventuale të hyrave nga ndonjë burim tjetër i përdorimit të deponive, me të cilën kompania siguron të hyra direkt ose indirekt.

### Komisioni për përgatitjen e projekt-propozimit të tarifës, përbërja dhe detyrat

#### Neni 5

- 1) Në çdo fund viti dhe pas miratimit të planit të biznesit për vitin në vijim, me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK SHA, themelohet komisioni për projekt-propozimin e tarifës për shërbimet e pranimit dhe të trajtimit të mbeturinave në deponitë sanitare dhe në stacionin e transferit.
- 2) Në komision preferohet të emërohen së paku pesë anëtarë (5), tre (3) prej të tyre duhet të përfaqësojnë sektorët që kanë impakt të drejtpërdrejtë në formësimin e tarifës, siç janë sektori i financave, sektori operativ dhe ai i administratës.

- 3) Afati kohor i përgatitjes së projekt-propozimit për tarifë nga ana e komisionit do të përcaktohet me vendim dhe data e fundit e përgatitjes së projekt-propozimit nuk mund të kalojë 15 marsin e vitit në vijim.
- 4) Përfshirja nga paragrafi 1) dhe 3), për projekt-propozimin e tarifës mund të këtë afate tjera, në rast se, MEA në cilësinë e rregullatorit për tarifë nxjerr akt të veçantë me të cilin përcakton periudha të tjera apo afate për kohëzgjatjen e vendimit të tarifës në fuqi.
- 5)

### **Detyrat e komisionit për projekt-propozimin e tarifës**

#### **Neni 6**

- 1) Komisioni i emëruar për të përgatitur projekt-propozimin për tarifë ka për detyrë që të bëjë përmbledhjen dhe përpunimin e të gjitha të dhënave që burojnë nga plani i biznesit, të dhënat e konstatuara nga regjistrimi/inventarizimi i pasurive (aseteve) dhe detyrimeve për vitin aktual, si dhe të dhënat nga terreni mbi gjendjen operative përfshirë hapësirat deponuese, infrastrukturën, makinerinë dhe pajisjet.
- 2) Komisioni gjatë punës bën një regjistër ("check listë") mbi veprimtaritë dhe aktivitetet e duhura në menaxhimin e deponive, veç e veç për secilën deponi, si dhe përmbledh edhe evidenca të tjera që lidhen me punën e komisionit, me qëllim të analizës sa më reale të kostos për menaxhimin e deponive sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- 3) Komisioni gjatë punës duhet të përpunojë në detaje kostot financiare të hyrave dhe të shpenzimeve, kostot e amortizimit dhe të zhvlerësimit të aseteve, kostot e investimeve dhe të donacioneve etj.
- 4) Komisioni gjatë punës do të përdorë referenca nga projektet studimore apo dokumente të ngjashme që janë bërë për KMDK SHA, referencat për pjesët që kanë të bëjnë me trajtimin e mbeturinave dhe investimet e sidomos referencat që kanë të bëjnë me vlerësimin e tarifës së shërbimit.
- 5) Komisioni gjatë punës së tij, do të shfrytëzojë edhe të dhënat publike të kompanive regjionale grumbulluese të mbeturinave, sidomos sa i përket gjenerimit dhe kostos së tarifës për ekonomi familjare dhe biznese. Kompanitë Regjionale të grumbullimit të mbeturinave komunale, duke qenë njëkohësisht klient të KMDK SHA, janë pjesë e rëndësishme e kalkulimit të proporcionit (%) që ndajnë për pagesë të tarifës ndaj KMDK SHA, dhe komisioni mund të analizojë ndarjen reale të këtyre proporcioneve (%) që do të ishte e arsyeshme për të nxjerr konkluzion real.
- 6) Komisioni gjatë punës mund të përdorë edhe referenca nga vendet e rajonit apo me gjerë për nivelin e tarifës, por gjithnjë gjatë atyre krahasimeve duhet marrë në konsideratë mënyrën e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave komunale.
- 7) Komisioni gjatë punës së vet përpos zbatimit të dispozitave të kësaj rregulloreje do të shërbehet edhe me metodologji të tjera nga "praktikat e mira"
- 8) Dokumentet mbështetëse për propozim tarifën do të ruhen në arkivin e KMDK SHA, dhe në rast se ato nevojiten për arsyetim apo plotësim të kërkesës nga rregullatori, të jenë të disponueshme.

### KAPITULLI III

## METODOLOGJIA, TË DHËNAT, ZËRAT E KOSTOVE DHE FORMULAT

### Përfshirja e të dhënave gjatë përgatitjes së projekt-propozimi të tarifës

#### Neni 7

- 1) Metodologjia përshkruan procedurat me të cilat KMDK SHA si ofrues i shërbimit do të kalkulojë një propozim-tarifë për mbulueshmërinë e kostove të menaxhimit, depozitimit dhe trajtimit të mbeturinave komunale dhe mbetjeve të tjera brenda, hapësirave të deponive sanitare.
- 2) KMDK SH.A, propozim-tarifën për trajtimin e mbeturinave komunale të pranuar në deponi do ta llogarisë në euro për ton [€/t], ndërsa kalkulimin e vlerës së kostos do ta bëjë në përputhje me Aneksin 1, të kësaj rregulloreje.
- 3) Llogaritja e projekt-propozimit të tarifës do të përfshijë edhe normat e taksave shtetërore përfshirë edhe taksat eventuale të cilat mund të vendosen në proces e sipër përmes akteve qeveritare (*si p.sh. Taksa Mjedisore\**).
- 4) Komisioni për llogaritjen e propozim-tarifës, do të përpunojë dhe do të përdorë sasinë e mbeturinave e cila është planifikuar të pranohet në vitin aktual, dhe sasinë e mbeturinave që është planifikuar për vitin në vijim, njëkohësisht do të marrë parasysh edhe sasinë e mbeturinave të pranuar në vitin paraprak. Ndryshimet e planifikuara eventuale për vitin aktual, duhet të jenë në përputhje me planet e menaxhimit të mbeturinave dhe dokumentet strategjike (*nëse paraprakisht ato janë aprovuar nga kompania/qeveria*).
- 5) Për çdo devijim/mospërputhje nga projekcionet e planifikuara, KMDK SHA do të paraqesë një shpjegim dhe arsyetim që ndërlidhet me ndryshimet mes planifikimit dhe realizimit të pranimit të sasisë mbeturinave komunale.
- 6) Në propozim-tarifë, kostoja për sa i përket sasisë së mbeturinave të planifikuara për t'u pranuar në deponi, do të zbatohet vetëm për periudhën kohore prej një viti.
- 7) KMDK SHA, do të paraqesë në mënyrë të saktë dhe të qartë kostot e vërtetuara ekonomike dhe teknologjike, dhe në projekt-propozim të tarifës, njëkohësisht do të përfshijë edhe kostot për pasuritë dhe aktivitetet që ndërlidhen me sigurimin e shërbimit të trajtimit mbeturinave.
- 8) KMDK SHA, do të justifikojë avantazhet e investimeve teknologjike për zgjidhje afatgjate të trajtimit të mbeturinave dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave për depozitim , duke synuar përfitimin nga nxjerrja e produkteve/nënprodukteve dytësore që mund të ndodhin, nga procesi i ndarjes dhe riciklimit si dhe nga procesi i trajtimit biologjik e mekanik i mbeturinave të biodegradueshme.
- 9) KMDK SH.A, në rast se ka të ardhura eventuale nga shitja e materialit/produktit të rikuperueshëm të ndarë apo të ricikluar do të zvogëlojë kostot e përfshira në projekt-propozim e tarifës, duke zvogëluar të ardhurat nga kostot për përgatitjen e materialit/produktit për shitje.
- 10) KMDK SH.A, do ta vlerësojë dhe do ta pëfshijë në propozim-tarifë çdo fitim si burim të nevojshëm për rezervat operationale dhe terheqëjen e aktiveve rrjedhëse.
- 11) KMDK SH.A, nuk do të përfshijë në projekt-propozim e tarifës kostot nga shërbimet eventuale të tjera të cilat nuk ndërlidhen me aktivitetin e kompanisë.
- 12) Kostot e shërbimit të depozitimit të mbeturinave të cilat llogariten sipas formulës së treguar në paragrafin 2, i nenit 10, të kësaj rregulloreje, duke përdorur për llogaritje shumën e fitimit që është e barabartë me përfitimin në tarifën e zbatueshme.

*YAH*

## Përfshirja e kostove në projekt-propozimin e tarifës

### Neni 8

- 1) **Kostoja që do të përfshihet në Projekt-propozimin e tarifës** nga Komisioni i KMDK SHA do të llogaritet si kosto e plote e shërbimit të trajtimit të mbeturinave komunale (**me Fitim-F**) në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$F = (\text{Pamort} + \text{KO} + \text{PT} + \text{PI}) - \text{H}_{\text{etj}} + \text{FLL}$$

Ku:

- **Pamort**, është përfshirja e amortizimit (*shpenzimet e zhvlerësimit-amortizimit*) të aseteve fikse dhe vlerës së investimeve jo materiale (€);
- **KO**, është kostoja operative (€);
- **PT**, është pagesa e taksave (€);
- **PI**, është pagesa e interesit të kredisë dhe ri-mbursimi i kapitalit, duke përfshirë kostot në lidhje me garancinë financiare ose garanci tjetër nga KMDK si menaxhuese e deponive (€)
- **H<sub>etj</sub>**, është e hyra/ardhura në përputhje me paragrafin 9, të nenit 7, të kësaj rregulloreje (€)
- **FLL**, është fitimi i llogaritur në mënyrë që përfitimi të jetë në përputhje me kushtet e përshkruara në paragrafin 9 të nenit 7, të kësaj rregulloreje, **ku FLL/Pf (€)**

- 2) **Amortizimi i aseteve fikse dhe fshirja e vlerës së investimeve jo materiale (Pamort)** llogariten sipas formulës vijuese:

$$\text{Pamort} = \text{Zhaf} + \text{Vipp}$$

ku

- **Zhaf**, është zhvlerësi i aseteve fikse (EUR);
  - **Vipp**, është vlera e investimeve të paprekshme të fshira (€).
- 3) Amortizimi i aseteve fikse llogaritet në përputhje me ligjet dhe rregulloret që rregullojnë fushën e kontabilitetit si dhe konform politikës së kontabilitetit të KMDK SH.A.
  - 4) Nëse KMDK SHA përdorë përfshirjen e pagesave të shumës kryesore të një kredie afatgjate të parashikuar në paragrafin 3, të nenit 9, të kësaj rregulloreje, në projekt-propozimin e tarifës, amortizimi i llogaritur do të zvogëlohet me shumën e amortizimit që korrespondon me vlerën e mbetur të aseteve fikse të treguara në paragrafin 3, të nenit 9, të kësaj rregulloreje.
  - 5) Nëse pasuritë fikse nuk përdoren me intensitet të plotë, zhvlerësi i llogaritur do të rregullohet në atë mënyrë që të korrespondojë me një përdorim efikas të aktiveve fikse.
  - 6) Fshirja e vlerës së investimit jomaterial ose kostoja e zhvillimit të kompanisë, (*kostot që vijnë nga koncesionet, patentat, licencat, markat tregtare dhe investimet e tjera jomateriale*) do të llogariten me përjashtim të vlerës jomateriale të kompanisë, duke marrë parasysh politikën e kontabilitetit të miratuar nga KMDK SH.A.
  - 7) Në llogaritjen e amortizimit për pasuritë fikse të cilat janë financuar nga një ndihmë financiare e marrë nga Shteti, vendi i huaj, Bashkimi Evropian ose nga ndonjë organizatë dhe institucion tjetër ndërkombëtar, vlera e aseteve fikse do të ulet nga vlera e ndihmës financiare përkatëse ose e ndihmës financiare e cila është treguar në pikën "Të Ardhura të Shtyra" të bilancit të kompanisë dhe e specifikuar në përputhje me procedurat e përcaktuara me të cilin ndihma financiare e Shtetit, vendi i huaj, Bashkimi Evropian ose organizata dhe institucione të tjera ndërkombëtare, donacionet dhe dhuratat në para ose në ne investime, do të pasqyrohen në pasqyrat financiare.
  - 8) **Kostot e Operimit (KO)**, do të llogariten në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$\text{KO} = \text{Kstaf} + \text{KtjAEK}$$

*Handwritten signature*

Ku:

- **Kstaf** , është kostoja e stafit (€);
  - **KtjAEK** – është kosto të tjera të aktivitetit ekonomik (€).
- 9) **Kostot e stafit/personelit (Kstaf)**, do të llogariten në përputhje me ligjet dhe rregulloret që rregullojnë marrëdhëniet juridike të punësimit dhe fushën e sigurimeve shoqërore. Personeli janë të gjithë punësuarit aktiv të KMDK SH.A të përfshirë në procesin operativ përfshirë edhe stafin administrativ, sipas modelit të caktimit të kostos të hartuar nga kompania dhe të paraqitur së bashku me projekt-propozimin e tarifës.
- 10) **Kosto të tjera të aktivitetit ekonomik (KtjAEK)**, janë kostot që lidhen me aktivitetin ekonomik të KMDK SH.A, të cilat janë të nevojshme për të siguruar shërbimin e trajtimit të mbeturinave dhe të cilat nuk përfshihen në zërat e tjerë të kostos. Kostot e referuara në Paragrafin 3 të Aneksit 1 të kësaj rregulloreje do të përfshihen në tarifatat e tjera operative:
- 10.1 kostot e operimit, riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, pajisjeve, mekanizmave dhe strukturave; kostot në lidhje me zvogëlimin e sasisë së mbetjeve të biodegradueshme për asgjësimin, *(përfshirë rikuperimin e mbetjeve të biodegradueshme dhe transportin në vendin e rikuperimit)*; kostot për materialet për sigurimin e shërbimit të asgjësimit të mbetjeve- *(përfshirë operimin, mirëmbajtjen, inspektimet teknike)*; dhe kostot e riparimit të automjeteve, pajisjeve, mekanizmave dhe strukturave të përfshira në proceset teknologjike të referuara në, nën paragrafin 3.1 të Aneksit 1, të kësaj rregulloreje, karburantit dhe kostot e energjisë elektrike, kostot për inspektimet teknike dhe sigurim, kostot e qirasë së një automjeti, pajisjet, mekanizmat ose strukturën, kostot për materialet për sigurimin e shërbimit të deponimit, të mbeturinave komunale, kostot nëse KMDK SH.A blen ndonjë nga shërbimet, si shërbim i kontraktimit dhe kostot e tjera të tipit të ngjashëm.
- 10.2 Kostot për kontrollimin e gjendjes dhe mbrojtjen e mjedisit gjatë operimit të deponisë, kostot e monitorimit të mjedisit, kostot e dezinfektimit-dezinsektimit-deratizimit, kostot në lidhje me kryerjen e matjeve gjeodezike në deponi, kostot për menaxhimin e gazit, kostot në lidhje me matjet dhe parandalimin e emetimit të kundërmimit dhe kostot e tjera të ngjashme.
- 10.3 Kostot e shpenzimit në lidhje me trajtimin mbetjeve shtazore dhe mbetjeve për asgjësim të ndara nga mbetjet komunale.
- 10.4 Kostot në lidhje me financimin e masave të edukimit dhe arsimit publik lidhur me trajtimin e mbeturinave *(nëse ka të tilla dhe nëse ato janë paraprakisht të aprovuara dhe të planifikuara për arsimin publik sipas planeve të qeverisë)*, këto kosto nuk duhet të kalojnë 2% të kostove të plota (me fitim) të përfshira në projekt-propozimin e tarifës.
- 10.5 Kostot për aktivitetet kërkimore dhe zhvillimore, do të përfshihen në përputhje me procedurat e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi *(nëse ka të tilla)*.
- 10.6 Kostot për mbylljen dhe rikultivimin e deponive dhe kostot në lidhje me monitorimin dhe mirëmbajtjen e deponive të mbyllura, duhet të përfshihen në projekt-propozimin për tarifë, dhe llogaritja duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore, duke marrë parasysh vlerën e kostos së paraparë që nevojitet për të mbuluar shpenzimet ndër-vite.
- 10.7 Kostot e administratës të cilat nuk janë përfshirë në zërat e tjerë të kostove - qiraja e objekteve administrative/zyrave dhe kostot e mirëmbajtjes së tyre, kostot e komunikimit dhe shërbimet postare, kostot në lidhje me hartimin e dokumenteve të brendshme *(plani i biznesit, raporti vjetor etj.)*, kostot e auditimit dhe shërbimet ligjore, furnizimet, kostot e udhëtimeve, trajnimet dhe seminarët, publikimet, kostot e përfaqësimit, kostot në lidhje me riparimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e automjeteve administrative dhe kostot e tjera të ngjashme.

- 10.8 Pagesat e taksave/tarifave, pagesat e taksave shtetërore, pagesat për kontribut-dhënje (TRUST), pagesat e shërbimeve publike, pagesat e sigurimeve, pagesa e tarifave për marrjen e lejeve/licencave, si dhe pagesat eventuale kundër ndotjes(*taksa mjedisore\**);
- 10.9 Kosto të tjera, - siguria e deponisë, siguria nga zjarri dhe kostot e planifikimit të përdorimit të tokës për deponinë, kostot në lidhje me blerjen e pajisjeve mbrojtëse të punës, kostot e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë dhe kostot e sigurimit të aksidenteve, kostot e energjisë elektrike të cilat nuk janë përfshirë në zërat e tjerë të kostove, dhe kostot e tjera të ngjashme.
- 11) **Pagesat e taksave (PT)**, në përputhje me dispozitat ligjore KMDK SH.A, do ti llogarisë pagesat e taksave, ku do të përfshihen taksat e mëposhtme që llogariten në kostot e plota të shërbimit të trajtimit të mbeturinave (**me fitim**):
- 11.1 Taksa e pasurisë së paluajtshme për ndërtesat, strukturat dhe tokën në pronësi, posedim ose mbajtje që përdoren për sigurimin e shërbimit të trajtimit të mbeturinave komunale;
- 11.2 Tatimi mbi të ardhurat e kompanisë për të ardhurat e marra nga sigurimi i shërbimit të pranimit të mbeturinave komunale;
- 11.3 Taksa eventuale mjedisore\* (*aktualisht nuk kërkohet*), të njëjta nuk do të përfshihet në kostot e plota të shërbimit të trajtimit të mbeturinave (me fitim) edhe në rast të aplikimit të tyre.

**Pagesat e interesit të kredisë dhe rimbursimi i kapitalit, duke përfshirë kostot në lidhje me garancinë financiare ose garancitë eventuale të përbashkëta me qeverinë**

**Neni 9**

- 1) KMDK SH.A, do të përfshijë pagesat e interesit të një kredie afatgjate (*5 vjet dhe më shumë*) në projekt-propozimin e tarifës, nëse kredia afatgjate përdoret për krijimin e aktiveve të reja fikse për sigurimin e shërbimit.
- 2) KMDK SH.A, mund të përfshijë pagesat e interesit të një kredie të arsyeshme afatshkurtër (*deri në 5 vjet*) në llogaritjen e projekt-propozimit të tarifës, nëse kredia përkatëse ka të bëjë me krijimin e aktiveve të reja fikse për sigurimin e shërbimit dhe ka për qëllim tërheqjen e fondeve monetare nga një shtet, qeveri, vend i huaj, Bashkimi Evropian, një organizatë ose institucion tjetër ndërkombëtar.
- 3) KMDK SH.A, mund të përfshijë shlyerjen e shumës kryesore të një kredie afatgjate (*5 vjet dhe më shumë*) në projekt-propozimin e tarifës, nëse amortizimi i aktiveve fikse të blera për kredinë përkatëse gjatë gjithë përdorimit të aktiveve fikse nuk është përfshirë në projekt-propozimin e tarifës, duke siguruar llogaritjen individuale të aktiveve të tilla fikse në sistemin e kontabilitetit.
- 4) Nëse pagimi i shumës kryesore të një kredie është përfshirë në tarifën e zbatueshme për shërbimin e trajtimit të mbeturinave komunale në përputhje me paragrafin 3, të këtij neni, KMDK SH.A, jo më vonë se gjashtë muaj para se të paguaj shumën kryesore të kredisë përkatëse, do të paraqet një projekt-propozim të ri të tarifës tek MEA, duke përjashtuar nga projekt-propozimi i tarifës amortizimin e aseteve fikse të blera për kredinë përkatëse.
- 5) Nëse afati i kredisë përfshihet në kostot që formojnë tarifën e aprovuar të shërbimit të trajtimit të mbeturinave komunale, kushtet për pagimin e interesit të kredisë ose shlyerjen e shumës kryesore rezultojnë me ndryshime, KMDK SH.A do të informojë MEA në lidhje me ndryshimet brenda një muaji pas ndodhjes së ndryshimeve përkatëse në kontratën me kreditorin.

*YEH*

**Llogaritja e projekt-propozimit të tarifës për shërbimin e deponimit të mbeturinave komunale**  
**Neni 10**

1) KMDK SH.A, do të llogarisë projekt-propozimin e tarifës për shërbimin e deponimit të mbeturinave komunale në përputhje me formulat e mëposhtme:

1.1 **Komponentët përbërëse të shërbimit të deponimit të mbeturinave komunale ( $K_{pshK}$ )** në (€ / T)

$$K_{pshK} = F / Q$$

Ku

-  $Q$ , është sasia e mbeturinave të planifikuara për t'u pranuar në deponi në vitin aktual (t);

1.2. **Taksa eventuale mjedisore\*** për sasinë e mbeturinave komunale të deponuara (TMJ) (€ / T)

$$TMJ = Q_{pd} / Q \times SHTM$$

ku

-  $Q_{pd}$  - sasia e mbeturinave që planifikohet të depozitohet në deponi në vitin aktual (T);

-  $SHTM$  - shkalla e taksës mjedisore\* për depozitim e një ton mbeturine komunale.

2) **Projekt-propozimit të tarifës** për shërbimin e deponimit të mbeturinave komunale së bashku me taksën mjedisore ( $P_{PT}SHTM$ ) në (€ / T), do të llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$P_{PT}SHTM = K_{pshK} + TMJ.$$

**Kontabiliteti i kostove dhe të ardhurave**  
**Neni 11**

- 1) Për të llogaritur tarifën, KMDK SH.A do të përdorë llogaritjen e kostove dhe të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për shërbimet publike, përkatësisht kontabiliteti do të përfshijë llogari të ndara, nëse kompania ofron edhe lloje tjera të shërbimit publik. Kontabiliteti i kostove do të ndahet nga kontabiliteti i përgjithshëm, duke përdorur llogari, nën-llogari ose tregues të tjerë duke përdorur programin e kontabilitetit dhe sistemin e brendshëm të kontabilitetit të kompanisë.
- 2) Kontabiliteti i KMDK SH.A është i rregulluar në bazë të dispozitave ligjore dhe akteve të brendshme të kompanisë, i tillë që nëse kërkohet nga aksionari të jetë i qasshëm për të gjitha transaksionet ekonomike në lidhje me shërbimin e depozitimit të mbeturinave komunale për gjatë gjithë periudhës së menaxhimit me deponitë sanitare.
- 3) KMDK SH.A, do të ndajë llogaritë e mëposhtme të të ardhurave në kontabilitet në lidhje me arsyetimin e projekt-propozimit të tarifës:
  - 3.1 Të hyrat nga tarifa për shërbimin e depozitimit të mbeturinave komunale;
  - 3.2 Të ardhurat sipas llojeve të veprimtarisë në përputhje me paragrafët 8, dhe 9, të nenit 7, të kësaj rregulloreje;
  - 3.3 Të ardhurat e tjera themelore operative (nëse është e nevojshme, KMDK SH.A do të sigurojë një nënndarje më të detajuar).
- 4) Të ardhurat, të cilat në momentin e llogaritjes nuk mund t'i atribuohen shërbimit të depozitimit të mbeturinave komunale, do të ndahen duke zbatuar modelin e caktimit të kostos të specifikuar sipas paragrafit 3, dhe 4, të nenit 4, të kësaj rregulloreje.
- 5) KMDK SH.A, duke përdorur programin e kontabilitetit dhe sistemin e brendshëm të kontabilitetit do të përfshijë informacione për llogaritjen, nën llogaritjen si dhe përfshirjen e treguesve të tjerë, të kostove dhe të ardhurave, për të siguruar të dhëna me të cilat formohet propozim-tarifa për shërbimet e trajtimit të mbeturinave komunale në përputhje me Aneksin 2, të kësaj rregulloreje.



## KAPITULLI IV DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 12

- 1) Përderisa Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (*në cilësinë e rregullatorit*), nuk e ka të aprovuar aktin zyrtar të saj, mbi metodologjinë e llogaritjes së tarifës, parimet themelore dhe mënyrën e llogaritjes, si dhe specifikimet e tjera të nevojshme, KMDK SH.A do të përdorë këtë model të kalkulimit të kostos, duke ju përmbajtur me përkushtim metodologjisë se përcaktuar me këtë rregullore si dhe duke u bazuar ne modelet e “praktikave të mira”.
- 2) Me rastin e nxjerrjes së Aktit të veçantë nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, mbi tarifën dhe metodologjinë e llogaritjes së saj, KMDK SH.A do të bëjë harmonizimin e dispozitave të kësaj rregulloreje me aktin e aprovuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.
- 3) Dispozitat e kësaj rregulloreje që kanë të bëjnë me taksat mjedisore\* do të jënë inaktive përderisa qeveria nuk e ka të aprovuar një taksë të kësaj natyre, ndërsa me rastin e aprovimit të taksës mjedisore\* nga ana e qeverisë, dispozitat e kësaj rregulloreje do të bëhen aktive si dhe do të harmonizohen me aktin e qeverisë.

### Neni 13

- 1) Pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje janë edhe anekset e bashkëlidhura të evidentuara si në vazhdim:
  - ANEKSI I: **Llogaritja e propozim tarifës për shërbimin e deponimit të mbeturinave sanitare**
  - ANEKSI II: **Llogaritë, nën-llogaritë dhe treguesit e përdorur në llogaritjen e projekt-propozimit të tarifës për shërbimin e menaxhimit të deponive sanitare**
- 2) Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Bordi i Drejtorëve, ditën e nënshkrimit të saj, nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të KMDK SH.A.

30/11/2020, Prishtinë

Mentor Hoxhaj  
  
Kryesues i BD të KMDK SH.A



## ANEKSI I

### Llogaritja e Propozim Tarifës për shërbimin e deponimit të mbeturinave sanitare

Nr	Artikulli/gjësendi	Emërtimi	Llogaritja e Propozim Tarifës
<b>1.</b>	<b>Amortizimi i Aseteve Fikse dhe shlyerja e vlerës së investimeve jomateriale</b>	<b>Inol.</b>	
1.1.	<b>Amortizimi i asetëve fikse, përfshirë:</b>	<b>Zhaf</b>	
1.1.1.	ndërtesat, strukturat		
1.1.2.	pajisje, makineri		
1.1.3.	të tjera		
1.2.	Vlera kontabël e investimeve të paprekshme të shlyera/fshira		
<b>2</b>	<b>Kostot e stafit</b>	<b>Kstaf</b>	
2.1.	Shpërblimi i punës		
2.2.	Kostot e sigurimeve shoqërore		
<b>3.</b>	<b>Kosto të tjera të veprimtarisë ekonomike</b>	<b>KtjAEK</b>	
3.1.	Kostot e operimit, riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, pajisjeve, mekanizmave dhe strukturave, si dhe kostot për materialet për sigurimin e shërbimit të hedhjes së mbetjeve të ngurta (përfshirë qiranë) për proceset e mëposhtme:		
3.1.1.	kostot për para-trajtimin biologjik mekanik të mbeturinave të ngurta për depozitim/asgjësim		
3.1.1.1	kostot për para-trajtimin mekanik të mbetjeve të ngurta		
3.1.1.2	kostot për trajtimin biologjik të mbeturinave (kompostimi, tretja anaerobe, transportimi në impiantin e trajtimit, etj)		
3.1.1.3	kostot për përgatitjen e mbetjeve për rigjenerim të mëtejshëm pas përpunimit mekanik (përgatitje për përpunim, transferim për përpunim, etj.)		
3.1.2.	<b>kostot për pranimin e mbeturinave të ngurta në stacionin e transferit dhe për transportin deri në deponi</b>		
3.1.3.	<b>kostot për sigurimin e asgjësimit të mbetjeve të ngurta</b>		
3.1.3.1	kostot për transportimin dhe vendosjen e mbeturinave në celulën/fushën e zbrazjes së deponisë, shtrirjen-nivelizimin, ngjeshjen, formimin e mbulesës ditore dhe shpateve, ndërtimin e rrugëve për qelizën e deponisë, mirëmbajtjen e tyre dhe kostot e tjera që nuk përfshihen në proceset e tjera teknologjike		
3.1.3.2	kostot për grumbullimin dhe shfrytëzimin e gazrave të deponisë		
3.1.3.3	kostot për menaxhimin e rrjedhjeve ujore të deponive dhe ujerave të ndotura		
3.1.4.	<b>kostot për mirëmbajtjen e objekteve të infrastrukturës së deponisë përveç atyre të përfshira në zërat e tjerë të kostos</b>		
3.2.	Kostot për kontrollin dhe mbrojtjen e gjendjes mjedisore gjatë funksionimit të deponisë		

3.3.	Kostot për menaxhimin dhe transferimin e mbetjeve të rrezikshme të ndara nga mbeturinat komunale		
3.4.	<i>Kostot për financimin e masave të edukimit publik në rajonin përkatës të menaxhimit të mbetjeve</i>		
3.5.	<i>Kostot për aktivitetet kërkimore dhe zhvillimore</i>		
3.6.	Kostot për mbylljen dhe rikultivimin e një deponi dhe kostot që lidhen me monitorimin dhe mirëmbajtjen e deponisë së mbyllur		
3.7.	Kostot e administrimit të cilat nuk janë përfshirë në zërat e tjerë të kostos		
3.8.	Pagesat e tarifave		
3.9.	Kosto të tjera		
<b>4.</b>	<b>Kostot e operimit, ne Euro (2. + 3.)</b>	<b>KO</b>	
<b>5.</b>	<b>Pagesat e taksave</b>	<b>PT</b>	
<b>6.</b>	<b>Pagesat e interesit të kredisë dhe rimbursimi i kapitalit, përfshirë shpenzimet në lidhje me garancinë financiare ose garancinë e barabartë nga operatori i deponisë</b>	<b>PI</b>	
<b>7.</b>	<b>Të hyrat në përputhje me Paragrafët 8, dhe 9 i nenit7, të kësaj Rregullore</b>	<b>H<sub>etj</sub></b>	
<b>8.</b>	<b>Kostot totale, ne Euro (1. + 4. + 5. + 6.) -7</b>		
<b>9.</b>	<b>Fitimi/përfitueshmëria</b>	<b>FLL</b>	
<b>10.</b>	<b>Te gjitha kostot (së bashku me fitimin), në Euro (8 +9)</b>	<b>PF</b>	
<b>11.</b>	<b>Sasia e mbeturinave të planifikuara për t'u pranuar në deponi në vitin aktual (t)</b>	<b>Q</b>	
<b>12.</b>	<b>Sasia e mbeturinave të planifikuara për t'u depozituar në deponi në vitin aktual (t)</b>	<b>Qpd</b>	
<b>13.</b>	<b>Proporcioni i sasisë së mbeturinave të deponuara dhe të pranuar në deponi,% (12./11.)</b>		
<b>14.</b>	<b>TARIFA PËR SHËRBIMIN E DEPOZITIMIT TË MBETURINAVE:</b>		
<b>14.1.</b>	<b>Komponenti i shërbimit të menaxhimit të mbeturinave (depozitimi, (€ /T) (10./11.)</b>	<b>K<sub>pshK</sub></b>	
<b>14.2.</b>	<b>Taksa e mjedisore për sasinë e mbetjeve të ngurta të asgjësuar, (€ /T) (12./11. * (kjo pjese do te harmonizohet nëse eventualisht aprovohet ndonjë takse e tillë)</b>	<b>TMJ</b>	
<b>14.3.</b>	<b>Tarifa për shërbimin e depozitimit të mbeturinave me taksën mjedisore, (€ /T) (14.1. + 14.2) (në normën e taksës mjedisore në përputhje me Ligjin nëse aprovohet ndonjë takse e tillë)</b>	<b>P<sub>PT</sub>SHT M</b>	

Shënim: shumat përfundimtare të përfshira në llogaritjen e projekt tarifës janë specifikuar sipas pozicioneve në vërtetimin e kostove / të ardhurave që formojnë draft tarifën

Datë \_\_\_\_\_

Komisioni për projekt-propozimin e tarifës \_\_\_\_\_

## ANEKSI II

### Llogaritë, nën-llogaritë dhe indikacionet e përdorura në llogaritjen e propozim tarifës për shërbimin e menaxhimit të deponive sanitare

Nr.	Kostot dhe zërat e të hyrave që formojnë tarifën *	Llogaria, nën-llogaria nr.____, ose tregues të tjerë të siguruar, duke përdorur programin e kontabilitetit dhe sistemin e brendshëm të kontabilitetit të KMDK SHA
1	1. Amortizimi i aseteve fikse dhe fshirja e vlerës së investimeve jomateriale	
2	2. Kostot e personelit	
3	3. Kosto të tjera të veprimtarisë ekonomike	
4	3.1 Kostot e operimit, riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, pajisjeve, mekanizmave dhe strukturave, si dhe kostot për materialet për sigurimin e shërbimit të shërbimin e menaxhimit të deponive sanitare (përfshirë qiranë) për proceset e mëposhtme:	
5	3.1.1. kostot për para-trajtimin biologjik mekanik të mbetjeve të ngurta për asgjësimin	
6	3.1.1.1. kostot për para-trajtimin mekanik të mbetjeve të ngurta	
7	3.1.1.2. kostot për trajtimin biologjik të mbetjeve (kompostimi, tretja anaerobe, transportimi në impiantin e trajtimit, etj.)	
8	3.1.1.3. kostot për përgatitjen e mbetjeve për rigjenerim të mëtejshëm pas përpunimit mekanik (përgatitje për përpunim, transferim për përpunim, etj.)	
9	3.1.2. kostot për pranimin dhe bartjes/ transportimin e mbeturinave nga stacionin e transferit për në deponi	
10	3.1.3. kostot për sigurimin e asgjësimit të mbeturinave	
11	3.1.3.1. kostot për transportin dhe vendosjen e mbetjeve inerte në celulen/fushen e zbrazjes në deponi, nivelimin, ngjeshjen, formimin e mbulesës ditore dhe shpateve, ndërtimin e rrugëve për qelizën e deponisë, mirëmbajtjen e tyre dhe kostot e tjera që nuk përfshihen në proceset e tjera teknologjike	
12	3.1.3.2. kostot për grumbullimin dhe shfrytëzimin e gazrave të deponisë	
13	3.1.3.3. kostot për menaxhimin e ujërave të ndotura dhe ujërave të zeza	
14	3.1.4. kostot për mirëmbajtjen e objekteve të infrastrukturës së deponisë përveç atyre të përfshira në zërat e tjerë të kostos	
15	3.2. Kostot për kontrollin dhe mbrojtjen e gjendjes mjedisore gjatë funksionimit të deponisë	
16	3.3. Kostot për menaxhimin dhe transferimin e mbetjeve të rrezikshme të ndara nga mbetjet e ngurta	
17	3.4. Kostot për financimin e masave të edukimit publik në rajonin	

	përkatës të menaxhimit të mbetjeve	
18	3.5. Kostot për aktivitetet kërkimore dhe zhvillimore	
19	3.6. Kostot për mbylljen dhe rikultivimin e një deponi dhe kostot që lidhen me monitorimin dhe mirëmbajtjen e deponisë së mbyllur	
20	3.7. Kostot e administrimit të cilat nuk janë përfshirë në zërat e tjerë të kostos	
21	3.8. Pagesat e tarifave	
22	3.9. Kosto të tjera	
23	5. Pagesat e taksave	
24	6. Pagesat e interesit të kredisë dhe rimbursimi i kapitalit, përfshirë shpenzimet në lidhje me garancinë financiare ose garancinë e barabartë nga operatori i deponisë	
25	7. Të hyrat në përputhje me Paragrafët 11 dhe 12 të Metodologjisë	
26	11. Sasia e mbeturinave të pranuar për asgjësim në deponi në vitin aktual (t)	
27	12. Sasia e mbeturinave të deponuara në deponi në vitin aktual (t)	

\* Numërimi dhe emrat korrespondojnë me artikujt e specifikuar në ANEKSIN I

Datë \_\_\_\_\_

Komisioni për projekt- propozimin e tarifës  
\_\_\_\_\_